



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 58.
Prishtinë, më 22.01.2013 në ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Xhevdet Neziraj.

Munguan: Glauk Konjufca dhe Petar Miletic.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues i OSB-së Elita Vokshi, përfaqësuese i Sekretariatit të KKK Zijush Ahmeti, përfaqësuese e Ambasadës Zvicerane Sakibe Jashari, përfaqësues i zyrës së Presidencës (ZPRK) Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Ilaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatorë - Natasa Prica-Tisma, zyrtarë e lartë ligjore, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Goran Marinkovic**, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Formimi i grupit punues i komisionit, për përgatitjen e Planit të punës për vitin 2013.**
- 4. Shqyrtimi i Raportit të punës për vitin 2012.**

Kryesuesi – konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – rendi i ditës u miratua pa vërejtje

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar.

Kryesuesi - konstatoi se komisioni, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtura më 21.12.2012, pa vërejtje.

3. Formimi i grupit punues i komisionit, për përgatitjen e Planit të punës për vitin 2013;

Kryesuesi, tha se Komisioni ka pas bashkëpunim të mirë dhe në bazë të detyrave të caktuar i ka respektuar procedurat e përcaktuara me Rregulloren e punës së Kuvendit, si gjatë ndryshimeve dhe plotësimeve të projektligjeve , gjithashtu dhe gjatë hartimit të raporteve me rekomandime për Kuvendin.

Lidhur me këtë pikë, ai propozoi që të formohet grupi punues në hartimin e planit të punës për vitin 2013.

Petar Miletic – u pajtua që të formohet grupi punues, ndërsa propozimi i tij dhe anëtarëve të komisionit është që në grup punues të jenë një anëtar i komunitetit shqiptarë, një i komunitetit serb dhe një nga komuniteti pakicë.

Propozimi i tij ishte që anëtare e grup punues të jetë Jasmina Zivkovic. Elmi Recçica- propozoi znj. Lumnije Morina dhe Kryesuesi – propozoi z. Albert Kinolli.

Pas propozimeve për formimin e grupit punues, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Në kuadër të hartimit të Planit të punës për vitin 2013, grupi punues do të ketë këtë përbërje: Albert Kinolli, Lumnije Morina dhe Jasmina Zivkovic.

4. Shqyrtimi i Raportit të punës për vitin 2012.

Kryesuesi, kur bëhet fjalë për vizitat jashtë vendit, e njoftoi komisionin se ka pas takime me përfaqësuesen e Ambasadës Zvicerane znj, Sakibe Jashari ku është diskutuar që komisioni të gjej një temë adekuate që të realizohet vizita në shtetin e Zvicrës. Gjithashtu ka pas takim me përfaqësuesit e Ambasadës Norvegjeze, jemi akorduar për temat që janë të rëndësishme për komunitete dhe presim që edhe kjo vizitë të realizohet këtë vit.

Petar Miletic- sa i përket raporteve janë korrekte por ishte i mendimit që në fund të raportit të jetë një pikë e veçantë, si rezyme, ku do të paraqiten rezultatet e punës së komisionit.

Propozimi i tij ishte që të organizohet një vizitë jashtë shtetit të Kosovës, ku do të mirën praktika të mira në rajon, si p.sh Kroaci, Mali i Zi. Sa i përket çështjes së vizitave ai u ndërlidh që të vizitohen shtetet ku fliten disa gjuhë, një shembull i mirë është rasti i Belgjikës, gjuha gjermane është gjuhë e barabartë në Parlamentin Belg.

Lirije Kajtazi – përshëndeti komisionin duke theksuar se ky vit të jetë me të arritura më të suksesshme. Rreth çështjes së vizitave jashtë shtetit, nuk ka model për të parë përvoja si realizohet mbrojtja e komuniteteve. Mirëpo komisioni ka pas aktivitete të ndryshme, siç është rasti i kongresit për të Drejtat njerëzore dhe se është mirë që kjo pikë të përshkruhet në raport.

Xhevdet Neziraj - në këtë komision mund të përdoren shumë mekanizma për mbrojtjen e komuniteteve por ceku se në të ardhmen duhet të jetë më funksionalë ku do të zgjidheshin shumë çështje më rezultate konkrete për komunitetet, ndërsa ky komision vetëm ka shqyrtuar vetëm anën ligjore se a janë shkel të drejtat apo jo të komuniteteve, Është i mendimit që komisioni të ketë një rol më aktivë ku do të zhvillohen tema të natyrave të ndryshme, p.sh të diskutohet për çështjen e marrëdhënieve ndëretnike etj.

Kryesuesi – veçoi se në kuadër të aktiviteteve të punës dhe përgjegjësi që ka, komisioni ka shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe interesat e komuniteteve, Njëherit janë kryer edhe shumë aktivitete tjera siç është mbikëqyrja e implementimit të ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Ai konsideron se duhet të jenë më aktiv të gjithë anëtarët, të dilet me prezantime të reja për çështjet aktuale ku dhe rezultatet do të jenë më të suksesshme.

Elmi Reçica - edhe përkundër angazhimeve parlamentare, nuk është i pajtimit se komisioni nuk ka qen azhur. Ai theksoi se në bazë të Rregullores së Punës, si komision i përhershëm ka shumë përgjegjësi nga se të gjitha çështjet që dërgohen i procedon pa vonesë, nga ana tkjetër sa i përket kolegjalitetit kemi funksionuar në mënyrën më të mirë.

Bëri ftesë që komisioni ti përmbahet detyrave dhe përgjegjësi të udhëzuara nga raporti i punës.

Në bazë të harmonizimit të qëndrimeve të veta, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim miratoi programin e punës për vitin 2012.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinković